

# DOKUMENT AKTUAL

## Roli i punës së të rinjve në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm

### Hyrje

Të rinjtë janë një fokus i rëndësishëm në parandalimin e radikalizimit sepse mund të jenë një grup shumë vulnerabël. Disa të rinj veçanërisht vulnerabël janë të vështirë për t'u kontaktuar. **Punonjësit që punojnë me të rinjtë dhe specialistët e tjerë që punojnë me të rinjtë në mjedise sociale duhet të jenë të përfshirë**, për të zbuluar shenjat e hershme të radikalizimit dhe për të ofruar alternativa. Ata gjithashtu mund të shërbejnë si shembuj pozitivë dhe mentorë. Punonjësit që punojnë me të rinjtë janë të trajnuar dhe me përvojë në punën me të rinjtë mbi shumë tema problematike (droga, shfrytëzimi seksual, kumari, bandat) dhe mund t'i përdorin këto aftësi për të kontribuar në parandalimin e radikalizimit<sup>1</sup>.

Në vitin 2017, u prodhuan **një numër manualësh dhe setesh me mjete** në nivel evropian për të ndihmuar punonjësit aktivë që punojnë me të rinjtë në këtë fushë. *'The contribution of youth work to preventing marginalisation and violent radicalisation'* nga Drejtoria e Përsëgjithshme për Arsimin dhe Kulturën (DG EAC) dhe *'Young people and extremism pack'* nga British Council dhe SALTO janë disa shembuj. Këto publikime të shkëlqyera ndjekin të tjerat, si p.sh. *'The preventative role of open youth work in radicalisation of open youth work'* nga Werner Prinzjakowitsch.

Këto përpjekje u diskutuan në takimin e RAN YF&C mbi *'Rolin e punës me të rinjtë në parandalimin e radikalizimit'* të datave 6-7 dhjetor 2017. Ky dokument aktual përshkruan rezultatet e këtij diskutimi, dhe thekson **rekomandimet dhe metodologjitë kyçe**. Punonjësit që punojnë me të rinjtë dhe ekspertët e tjerë mund ta përdorin këtë dokument si udhëzues për mësimet bazë rreth PVE në këtë sektor, dhe të konsultohen me referencat me materiale më të detajuara.

Ky dokument aktual është shkruar nga **Merle Verdegaal** dhe **Wessel Haanstra** nga **RAN Centre of Excellence**. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument janë ato të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e RAN Centre of Excellence, të Komisionit Evropian apo të ndonjë institucioni tjetër.

<sup>1</sup> f. 46. DG EAC (2017)

## Përpyjekjet ekzistuese

Për vitin 2017, RAN YF&C planifikon të prodhojë një manual mbi *'Rolin e punës me të rinjtë në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm'*. Ky manual do të trajtojë të rinjtë dhe fuqizimin e punonjësve që punojnë me të rinjtë për të parandaluar radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm (PVE), si edhe nxjerrjen e rekomandimeve për ligjvënësit rreth kësaj teme. Ndërkohë, janë prodhuar një numër manualësh dhe dokumentesh udhëzuese rreth kësaj teme në nivel evropian.


Pjesëmarrësit në takimin e RAN YF&C të datave 6-7 dhjetor i diskutuan këto publikime dhe arritën në përfundimin se secila kishte pikat e veta të forta unike dhe përjasjet ndaj punës me të rinjtë dhe se ato plotësonin njëra-tjetrën. Duke kombinuar metodologjitë, rekomandimet dhe ushtrimet e të gjitha këtyre përpyjekjeve, punonjësit që punojnë me të rinjtë do të përgatiten mirë dhe do të njoftohen rreth opsioneve për parandalimin e radikalizimit si punonjës që punon me të rinjtë. Mësimi rreth PVE u lejon gjithashtu punonjësve që punojnë me të rinjtë të kuptojnë se çfarë nuk është radikalizim dhe ekstremizëm, duke parandaluar stigmatizimin dhe dëmtimin e panevojshëm. Pjesëmarrësit theksuan se puna me të rinjtë nuk duhet të jetë tepër e instrumentalizuar për përpyekje të tilla si PVE. Kjo pasqyron mesazhin e përbashkët që vjen nga këto publikime të reja dhe do të diskutohet në këtë dokumente: parandalimi i radikalizimit mund të bëhet duke ndërtuar mbi pikat kyçe të forta të punës me të rinjtë në përgjithësi: duke fuqizuar të rinjtë.

## Kontributi i punës me të rinjtë për të parandaluar marginalizimin dhe radikalizimin e dhunshëm – DG EAC

DG EAC publikoi një set praktik mjetesh rreth kontributit të punës me të rinjtë për të parandaluar marginalizimin dhe radikalizimin e dhunshëm. Ai argumenton se puna me të rinjtë *"i përket fushës së arsimit (jashtëshkollor), si edhe aktivitete specifike të kohës së lirë të menaxhuara nga punonjësit profesionistë ose vullnetarë me të rinjtë dhe liderët e të rinjve"*. Vlera e punës me të rinjtë qëndron te pranimi i nevojës për fleksibilitet dhe adresimin e realitetit të të riut. Puna me të rinjtë luan një rol në *"ndërtimin e rezistencës demokratike dhe fuqizimin e të rinjve për t'u bërë pjesëmarrës aktivë në shoqërinë demokratike evropiane"*<sup>2</sup>. Në setin e mjeteve, DG EAC dallon tri lloje parandalimi ku mund të kontribuojë puna me të rinjtë: gjenerik, i targetuar dhe i caktuar.

---

<sup>2</sup> f. 46 DG EAC (2017)



Imazhi 1 'Niveli i parandalimit me tri nivele'<sup>3</sup>

## Parandalimi gjenerik

Parandalimi gjenerik targeton të gjithë të rinjtë në mënyrë të tërthortë. Kontributi i punës me të rinjtë në nivel gjenerik është për t'i pajisur të rinjtë me aftësi jetësore që kontribuojnë për rezistencën e tyre demokratike dhe forcimin e vlerave të tyre demokratike<sup>4</sup>.

Punonjësit që punojnë me të rinjtë në këtë nivel duhet që:

- të jenë ndërmjetës dhe instruktorë kur diskutojnë tema të vështira ose tema që nuk i njohin mirë;
- të diskutojnë pyetje me kuptim me të rinjtë në një mjedis të sigurt;
- të guxojnë të diskutojnë tema tabu<sup>5</sup>;
- të njohin tendencat, të guxojnë të konfrontojnë të rinjtë, të sintonizohen me realitetin e të rinjve;
- t'u japin mundësinë të rinjve të kuptojnë të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike në praktikë;
- të jetë të ndërgjegjshëm për vlerat e tyre dhe identitetin e tyre të qartë; të kenë akses në aftësitë e tyre për vetëreflektim,
- mendim kritik dhe rezistencë emocionale;
- të inkurajojnë diskutimet ndërkulturore dhe ndërfaqetare që theksojnë vlera të përbashkëta;
- të shfrytëzojnë në maksimum mundësitë ekzistuese për trajnim rreth proceseve të radikalizimit të dhunshëm;
- të japin narrativa pozitive për të luftuar ideologjitë ekstremiste;
- të informojnë të rinjtë rreth rrjeteve publike antidiskriminuese.

Ekziston një mbivendosje e fortë mes objektivave dhe aktiviteteve të punës me të rinjtë në përgjithësi dhe objektivave dhe aktiviteteve të parandalimit gjenerik. Ky thekson një konkluzion të rëndësishëm: puna me të rinjtë si e tillë është tashmë një mjet i rëndësishëm në parandalimin e radikalizimit.

<sup>3</sup> f. 16 DG EAC (2017)

<sup>4</sup> f. 7 DG EAC (2017)

<sup>5</sup> Raporti i RAN YF&C (2018)

## Parandalimi i targetuar

Parandalimi i targetuar synon të arrijë të rinjtë që shfaqin tendenca ose janë të interesuar për ideologji dhe propagandë antidemokratike, ekstremiste (ose fragmente të këtyre ideologjive). Ata gjithashtu mund të jenë pranë grupeve ekstremiste ose kanë qenë tashmë në kontakt me këto grupe<sup>6</sup>. Në nivelin e parandalimit të targetuar, puna me të rinjtë mund të jetë efikase si në kontekstin individual ashtu edhe në grup.

Punonjësit që punojnë me të rinjtë në këtë nivel duhet që:

- të vihen në dijeni kur të rinjtë presin lidhjet me grupin e tyre social: kjo mund të jetë një shenjë radikalizimi të dhunshëm;
- të provojnë të identifikojnë sinjale dhe t'i aksesojnë ato saktësisht: shpesh ato janë thjesht thirrje për të tërhequr vëmendjen;
- të krijojnë/ndërtojnë një marrëdhënie besimi përpara se të ballafaqohen me të rinjtë me probleme ideologjike;
- të punojnë me mentalitetin e të rinjve;
- të familjarizohen me kontekstin social rreth të rinjve dhe të jenë të gatshëm të ndërhyjnë në terren;
- të përdorin aktivitetet e edukimit me personat e afërt për të parandaluar që të rinjtë të mos përfshihen në rrethet ekstremiste;
- të zbulojnë motivet dhe arsyet e të rinjve për bashkimin me grupet ekstremiste dhe të zhvillojnë strategji dhe alternativa sociale;
- të krijojnë hapësirë dhe të përfshihen në dialog – të trajnohen në teknikat e mundësimit të dialogut;
- të familjarizohen me proceset dhe dinamikat e radikalizimit të dhunshëm dhe të propagandës, si edhe motivet dhe tërheqjen.

Parandalimi i targetuar nuk është aq pjesë e punës së përditshme të punonjësve që punojnë me të rinjtë sa parandalimi gjenerik. Prandaj do të jetë e dobishme që të kenë njohuri rreth procesit dhe shenjave të radikalizimit. Manuali i SALTO<sup>7</sup> ofron njohuri historike rreth faktorët tërheqës për radikalizimin, si edhe shenjat e radikalizimit. Megjithatë, këshillohet që të mësoni më shumë rreth zbulimit të shenjave të radikalizimit në një seminar trajnues. Informacione më të thella disponohen në uebsajtin e Radicalisation Awareness Network<sup>8</sup>.

Pjesëmarrësit në këtë takim të RAN YF&C përmendën vlerën e shtuar të lojës në këtë fazë. Të rinjtë mund të jenë aq të përfshirë në ideologjinë ekstremiste në këtë pikë, sa nisja e një dialogu mund të jetë vështirë. Në këtë rast, mund të krijojë hapje një përjasje më shumë në formë loje. Në materialet shtesë të dhëna nga SALTO, jepen shumë ushtrime dhe lojëra që mund t'i ndihmojnë të rinjtë të aplikojnë këto teknika<sup>9</sup>.

<sup>6</sup> f. 8 DG EAC (2017)

<sup>7</sup> f. 8 dhe f. 21-24 British Council & SALTO Youth (2017)

<sup>8</sup> Uebsajti i Radicalisation Awareness Network ( )Online

<sup>9</sup> SALTO (2017) 'Additional material'

## Parandalimi i caktuar

“Parandalimi i caktuar” targeton të rinjtë që janë tashmë të përfshirë në një grup ekstremist ose me ideale ekstremiste dhe që duan të largohen prej saj (ose që konsiderohen të hapur për të marrë mbështetje për t’u larguar). Kjo punë parandaluese duhet të ofrohet vetëm nga ekspertë dhe të rinj që janë specifikisht të trajnuar për këtë<sup>10</sup>. Këtu, të rinjtë, së bashku me profesionistë të tjerë kyçë, mund të mbështesin të rinjtë për të dalë nga këto grupe.

Punonjësit që punojnë me të rinjtë në këtë nivel duhet që:

- të ndërtojnë një lidhje besimi me të rinjtë me të cilët punojnë;
- të sigurohen se mund të plotësojnë sfidat përpara ndërhyrjes;
- të formojnë aleanca me faktorët kyçë në komunitet;
- të kuptojnë procesin, të punojnë rreth shkaqeve dhe të zhvillojnë alternativa;
- t’i afrohen familjes, të njihen me dinamikën e saj dhe të kërkojnë personin e duhur për të marrë miratimin përpara ndërhyrjes;
- të zhvillojnë protokolle sigurie për të garantuar sigurinë për të riun dhe për veten;
- të bashkëpunojnë me ekspertë nga sektorë të ndryshëm si OJQ, shkollat, institucionet e drejtësisë, sigurisë dhe institucionet sociale.

Siç përcaktohet, parandalimi përfshin njohuri dhe aftësi të specializuara, jo të gjithë punonjësit që punojnë me të rinjtë do të jenë të trajnuar dhe të pajisur për të kryer këtë lloj pune. Punonjësit që punojnë me të rinjtë që nuk janë të trajnuar dhe të pajisur për të ekzekutuar parandalimin e caktuar, por që mendojnë se është i nevojshëm, duhet të kontaktojnë një koleg të trajnuar ose ekspert bashkëpunëtor.

## Të rinjtë dhe ekstremizmi: një paketë burimesh – SALTO-Youth

SALTO fokusohet te rëndësia e “punës civile me të rinjtë” në fushën e gjerë të rinisë dhe ekstremizmit. Kjo lloj pune me të rinjtë trajton të rinjtë për të sjellë ndryshim në çështjet që kanë rëndësi për ta në jetën e përditshme<sup>11</sup>. Ajo vazhdon perspektivën se me të rinjtë nuk duhet të sillemi sikur do të jenë qytetarë të plotë kur të rriten, por si “qytetarë tani”<sup>12</sup>: ata janë personat me kapacitetet e tyre për t’u bërë nismëtarë dhe agjentë të ndryshimeve sociale, dhe partnerë të barabartë për ta bërë botën një vend pa ekstremizëm të dhunshëm.

Elementet kryesore të punës civile me të rinjtë janë si vijon<sup>13</sup>:

- fokusohet më shumë se metodat e tjera te “alfabetizmi civil” (çfarë do të thotë të jesh demokratik dhe të jetosh në mënyrë demokratike?);

<sup>10</sup> f. 9 DG EAC (2017)

<sup>11</sup> f. 18 British Council & SALTO Youth (2017)

<sup>12</sup> 2 British Council & SALTO Youth (2017)

<sup>13</sup> 18 British Council & SALTO Youth (2017)

- është një përjasje më politike ndaj punës me të rinjtë: ajo sfidon normat e pranuar sociale (çfarë është normale? kush e vendos këtë?);
- mbështet të rinjtë ndërsa analizojnë marrëdhëniet e pushtetit dhe sfidojnë dinamikën e pushtetit, veçanërisht në situatat ku ndihen të pafuqizuar.

Bazuar në këto elemente kyçe, paketa e burimeve ofron rekomandime dhe përjasje të ndryshme për t'i ndihmuar të rinjtë të kuptojnë dhe të parandalojnë radikalizimin, dhe t'i ndihmojnë të rinjtë të përmirësojnë mendimin e tyre kritik<sup>14</sup>. Manuali ofron gjithashtu ushtrime praktike për secilën prej këtyre përjasjeve:

- **Marrëdhënia në punën me të rinjtë.** Megjithëse një pjesë e punës së përditshme e një punonjësi që punon me të rinjtë, ndërtimi i marrëdhënieve është i rëndësishëm për PVE. Suksesi i të gjitha aktiviteteve të tjera me të rinjtë varet nga besimi që krijohet në këtë mënyrë. Edhe për të rinjtë, cilësia e marrëdhënieve është e rëndësishme për t'u ndierë si pjesë e një komuniteti të caktuar.
- **Ndërtimi i ekipit.** Kjo krijon marrëdhënie kuptimplota mes të rinjve. Marrëdhëniet kuptimplota mund të krijojnë një ndjesi përkatësie, që pjesëmarrësit në takimin e RAN YF&C e gjejnë të rëndësishme për parandalimin e radikalizimit.
- **Puna në grup.** Përmes punës në grup, të rinjtë mund të artikulojnë se çfarë duan më shumë, t'u përgjigjen temave delikate, të përmirësojnë mendimin e tyre kritik, të sfidojnë stereotipat, mitet, bindjet dhe perceptimet. Të gjitha këto aftësi do të ndihmojnë të rinjtë të ndërtojnë motivimin për të bërë ndryshimin dhe për të qenë qytetarë aktivë brenda një shoqërie demokratike.
- **Angazhimi civil dhe/ose politik.** Ka një numër mënyrash përmes të cilave mund të mbështetet angazhimi civil dhe politik i të rinjve. Këto përfshijnë: prezantimin e edukimit civil dhe politik në mjedisin zyrtar shkollor, krijimin e mundësive për të qenë vullnetarë dhe për t'i shërbyer komunitetit lokal, garantimin që të rinjtë të konsultohen si pjesë e proceseve politikëbërëse dhe për të krijuar nisma për të inkurajuar të rinjtë që të regjistrohen për të votuar. Qenia pjesë e një ndryshimi social ndihmon gjithashtu adresimin e ndjenjës së pafuqishmërisë që mund të përjetojnë të rinjtë - dhe ndonjëherë është mbizotëruese mes atyre që përfshihen në ekstremizëm të dhunshëm.<sup>15</sup>
- **Angazhimi në komunitet.** Të rinjtë ndonjëherë mund të ndihen të shkëputur nga të tjerët në lagjen e tyre, veçanërisht nëse trajtohen me dyshim ose shihen si ngatërrestarë të mundshëm. Kjo mund t'i largojë ata nga baza e shoqërisë dhe t'i bëjë të rinjtë më të prekshëm ndaj rekrutimit ekstremist<sup>16</sup>. Shumë të rinj ndihen pjesë e lagjes ose e komunitetit si hap i parë për t'i bërë ata të ndihen pjesë e shoqërisë. Kjo mund të bëhet përmes vizitave studimore, projekteve të shkëmbimit ose duke ftuar një folës nga një komunitet i caktuar etnik ose fetar.

Përjasjet e lartpërmendura mund t'i ndihmojnë të rinjtë të ndërtojnë rezistencë konjitive dhe emocionale ndaj ekstremizmit, dhe angazhim në sjellje ndaj bazës së shoqërisë. Këto përjasje

<sup>14</sup> f. 26-44 British Council & SALTO Youth (2017)

<sup>15</sup> f. 34 British Council & SALTO Youth (2017)

<sup>16</sup> f. 2 Raporti i RAN (2016)

mund të kategorizohen kryesisht nën parandalimin e përgjithshëm brenda dokumentit të DG EAC (shikoni faqen 3). Megjithatë, Manuali i SALTO ofron gjithashtu edhe disa rekomandime për t'iu afruar individëve që janë tashmë nën influencën e ekstremizmit (parandalimi i targetuar dhe i caktuar):

- **Emocionet:** Ndhmoni ruajtjen e lidhjeve të të riut me ambientin e tij social si edhe arsimin e tij.
- **Aftësitë njohëse:** Diskutimi dhe dialogu për të kuptuar motivimet e të riut mund ta inkurajojë atë të zhvillohet në aspekte të tjera të identitetit të tij, p.sh. aspirata për karrierë, shprehi kulturore dhe sport.
- **Sjellja:** Ndhmon që personi të vazhdojë të jetë i përfshirë në aktivitetet me të rinjtë.

Së fundi, manuali i SALTO thekson rëndësinë e të kuptuarit të kontekstit lokal. Manuali ofron teknika të shumta që mund t'i ndihmojnë punonjësit që punojnë me të rinjtë të eksplorojnë dhe të kuptojnë mjedisin e tyre lokal me të rinjtë: shikoni kapitujt rreth analizës kontekstuale dhe studimit të veprimit.<sup>17</sup>

## Roli parandalues i punës së hapur me të rinjtë në radikalizim dhe ekstremizëm – Werner Prinzjakowitsch

Pas dokumentit të RAN (2016) mbi 'Arsyet bazë të radikalizimit', W. Prinzjakowitsch (2017) argumenton se të rinjtë, kur janë duke krijuar identitetin e tyre, kërkojnë perspektivë shpirtërore dhe praktike. Nëse mungon ndonjë prej tyre, ata bëhen veçanërisht vulnerabël ndaj rekrutimit nga ekstremistët.

Duke ndjekur këtë argument, "*puna e hapur me të rinjtë*" përmban karakteristika specifike që janë të rëndësishme kur bëhet fjalë për parandalimin e radikalizimit dhe të ekstremizmit. Termi '*puna e hapur me të rinjtë*' i referohet "*mundësimit të të rinjve, që do të thotë t'u jepet atyre mundësia të veprojnë përtej kërkesave të botës së të rinjve dhe mjedisit të punës.*"<sup>18</sup> Kjo synon mundësimin e vetëshprehjes dhe vetëefikasitetit dhe krijimin e një mjedisi vlerësues ku të rinjtë mund të rriten. Parimet e mëposhtme të punës së hapur me të rinjtë fitojnë rëndësi të veçantë kur bëhet fjalë për PVE<sup>19</sup>:

- **Çiltërsia:** Puna e hapur me të rinjtë në përgjithësi është e hapur për të gjithë të rinjtë, pa kushtëzime. Nuk ka asnjë presion apo angazhim, ndërsa anonimiteti është i garantuar. Kjo i bën të rinjtë të ndihen të mirëpritur, edhe nëse ndihen të përjashtuar nga shoqëria.
- **Krijoni një mjedis të hapur por edhe të sigurt dhe ndërtues për mosmarrëveshjet dhe diskutimin:** Merrini dhe pranojini të rinjtë siç janë, me të gjitha opinionet e tyre. Jepuni një hapësirë të sigurt për të diskutuar këto opinionet, pa i lënë të rinjtë të marrin kontrollin. Duke

<sup>17</sup> f. 44 British Council & SALTO Youth (2017)

<sup>18</sup> f. 61 W. Prinzjakowitsch (2017)

<sup>19</sup> f. 77-82 W. Prinzjakowitsch (2017)

ofruar një hapësirë të sigurt për të diskutuar këto opinione, ata nuk do të jenë të detyruar t'i diskutojnë ato në zona ku ekstremistët mund të ndërhyjnë.

- **Kini pozicion të qartë dhe të argumentueshëm politik dhe shpreheni qartë:** Duke pasur një qëndrim pranimi ndaj të rinjve nuk do të thotë se nuk duhet të keni qëndrimin tuaj privat, ndoshta të një opinioni të ndryshëm politik. Punonjësit që punojnë me të rinjtë duhet të jenë autentikë. Në zonën delikate të ideologjisë ekstremiste, nuk mund të promovohen këndvështrime që dikush nuk i mbështet personalisht 100%.
- **Njihuni me botën e të rinjve:** Njohuritë e qarta rreth mjedisit ku jetojnë, kushteve shoqërore, ekonomike dhe kulturore të të rinjve, janë një kusht paraprak themelor për të punuar me ta.
- **Pajisuni me njohuri profesioniste rreth çështjeve që janë të rëndësishme për të rinjtë:** Në diskutimet e lidhura me PVE, punonjësit që punojnë me të rinjtë mund të kenë frikë se mos u mungon njohuria rreth fesë apo ndonjë ideologjie të caktuar. Gjithsesi, nuk është e rëndësishme njohuria e thellë, por njohuria e qëndrueshme. Kjo vlen edhe për temat dhe çështjet e tjera që janë të rëndësishme për të rinjtë: nuk është nevoja të jesh doktor për të diskutuar drogat me të rinjtë. Nëse nevojiten njohuri të thella, ftoni një ekspert që t'i japë këto.
- **Gjykoni sjelljen, jo personin:** Një marrëdhënie e qëndrueshme profesioniste në bazë vullnetare mund të funksionojë vetëm me një vlerësim reciprok të personave të përfshirë. Në rastin e sulmeve verbale ose fizike, sjellja e gabuar e personit duhet të jetë fokusi i kritikës dhe jo personi vetë, veçanërisht kur bëhet fjalë për dhunën, glorifikimin e dhunës apo për racizmin, pavarësisht nëse është verbal apo fizik.
- **Caktoni kufij të qartë duke e respektuar njëkohësisht personin:** Kufijtë duhet të shpjegohen në mënyrë koherente dhe nuk duhet të shfaqen si të rastësishëm. Shkelja e atyre kufijve duhet të adresohet menjëherë dhe në mënyrën e duhur, ndonjëherë duke kërkuar edhe masa. Që të rinjtë të arrijnë orientim, kufijtë e qartë janë shumë të rëndësishëm.
- **Kini parasysh se parandalimi kërkon kohë dhe vazhdimësi:** Mos prisni rregullime të shpejta. Puna parandaluese ka nevojë për kohë dhe vazhdimësi.

## Rekomandime të mëtejshme

Të gjitha publikimet e diskutuara në këtë dokument aktual mund të ofrojnë asistencë të konsiderueshme për punonjësit që punojnë me të rinjtë për të kuptuar dhe për të punuar mbi parandalimin e radikalizimit. Prandaj, RAN YF&C këshillon të gjithë profesionistët që punojnë në fushën e punës me të rinjtë që të shohin më nga afër dhe të përfitojnë nga materiali i disponueshëm. Çdo publikim ka pika të ndryshme të forta, që variojnë nga sfondi teorik deri te rekomandimet dhe ushtrimet shumë praktike. Megjithëse jo të gjitha rekomandimet mund të jenë të aplikueshme për secilën situatë, bollëku i materialeve duhet të ofrojë mësim që janë të dobishme për shumicën e njerëzve.



Qendrat rinore dhe autoritetet përkatëse duhet t'u japin punonjësve që punojnë me të rinjtë një mundësi për të përfituar nga këto publikime: duhet të inkurajohet në mënyrë proaktive shpërndarja dhe dhënia e kohës për të lexuar dhe diskutuar materialet. Edhe më mirë është organizimi i seminareve trajnuese mbi PVE në të cilat konsultohen materialet ekzistuese.

Në fund, pjesëmarrësit në takimin e YF&C identifikuan aspekte të ndryshme të punës me të rinjtë ku mund të jenë të dobishme përpjekjet shtesë në lidhje me PVE. Gjatë takimit, u diskutuan një numër projektesh që (do të) fokusohen në mbushjen e këtyre boshllëqeve. Më poshtë diskutohen disa shembuj, si nga ky takim ashtu edhe në takime të mëparshme.

### Puna me të rinjtë online

Të rinjtë kalojnë një sasi të konsiderueshme të kohës së tyre online. Ekstremistët e dinë se ku t'i gjejnë; ata u japin atyre propagandë të cilësisë së lartë dhe u afrohen atyre dhe i rekrutojnë në mënyrë aktive online<sup>20</sup>. Prandaj pjesëmarrësit argumentojnë se edhe punonjësit që punojnë me të rinjtë duhet të punojnë më shumë online. Në lidhje me PVE, punonjësit që punojnë me të rinjtë kanë mënyra të shumta për të punuar online: duke ofruar narrativa alternative dhe duke u përfshirë direkt me të rinjtë online, për shembull në median sociale. Pjesëmarrësit ranë dakord se puna online mund të forcojë, por asnjëherë të zëvendësojnë, punën me të rinjtë në jetën reale.

#### Jamal el Khitab (AT)

Ekipi kryesor prapa projektit 'Jamal' përbëhet nga nëntë persona (të rinj dhe të rritur), katër prej të cilëve mund të thuhet se janë ish-mbështetës të ISIS-it ose që u kanë kthyer kurrizin mjediseve xhihadiste. Ajo që i bashkon ata është se janë të gjithë të rinj myslimanë që duan të luftojnë kundër ekstremizmit fetar.

Të mbështetur nga një ekip të rinjsh dhe ekspertësh të tjerë, ekipi prodhoi një seri videosh që tregonin historinë e sajuar të Jamal, një i ri që shkoi në Austri kur ishte fëmijë. Jamal diskuton shqetësimet që ai ka dhe vë në dyshim identitetin islamik, duke dhënë një alternativë ndaj ideologjisë ekstremiste. Videot tregojnë histori të marra direkt nga jeta e të rinjve. Ato mund të shihen në <https://www.youtube.com/watch?v=sJkBZRn82kY>

Pas postimit të këtyre videove në kanalet online ku mund të gjenden grupet e targetuara (të rinjtë e interesuar për ideologjinë ekstremiste), punonjësit që punojnë me të rinjtë u përfshinë në diskutime dhe procese reflektuese me ata që reagojnë ndaj përmbajtjes (puna e rrugës online).

<sup>20</sup> Raporti i RAN (2015)

### WebWalkers (FR)<sup>21</sup>

Frymëzuar nga programi i ngjashëm Fryshuset (SE), Institucioni Kombëtar për Familjet, të rinjtë, organizatat rinore dhe familjet bashkëpunojnë për të mësuar se çfarë mund të bëjnë të rinjtë dhe çfarë nuk duhet të bëjnë kur janë online, dhe si duhet të mbrojnë veten. Të rinjtë u mësohen aftësitë për botën virtuale në seminare në jetë reale të drejtuara nga punonjës që punojnë me të rinjtë.

Së dyti, programi i trajnon punonjësit që punojnë me të rinjtë se si të angazhohen me të rinjtë për të diskutuar tema të vështira. Programi po zhvillohet më tej në vitin 2018 për t'iu adresuar në mënyrë specifike sfidave dhe temave që lidhen me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

### Puna e shkëputur me të rinjtë

Shumë prej teknikave dhe metodologjive të theksuara në materialet ekzistuese kërkojnë një mjedis të kontrolluar, si p.sh. qendër rinore. Këto teknika janë më pak të dobishme për punonjësit që punojnë me të rinjtë që punojnë në rrugë (e referuar gjithashtu si punë e shkëputur ose punë e lëvizshme me të rinjtë). Megjithëse publikime e DG EAC, SALTO dhe

W. Prinzjakowitsch vazhdojnë të japin rekomandime shumë të dobishme për punonjësit që punojnë me të rinjtë, disa aftësi specifike mund të jenë të dobishme.

### Vaja Kitab (DE)

Punonjësit që punojnë me të rinjtë në Vaja Kitab kërkojnë të rinj në sferën publike dhe gjithashtu të punojnë me ta në terren. Kjo do të thotë se ata i takojnë të rinjtë në “zonën e tyre komode” në lidhje me qëndrimet dhe motivet e sjelljes.

Punonjësit që punojnë me të rinjtë në Vaja Kitab punojnë gjithashtu edhe me të rinjtë e përfshirë në ekstremizmin e djathtë. Për të punuar me ekstremizmin, aplikohen elemente të ndërmjetësimit, trajnimit antiracist dhe ndërkulturor, trajnimit kundër dhunës dhe trajnimit në aftësi sociale dhe personale. E fundit, por jo më e vogla, aktivitetet me interes të përbashkët (si p.sh. sporti), përdoren për të bashkuar anëtarë të klikave dhe skenave të djathta/mizantropë dhe personave nga jashtë ambienteve (ekstreme) të djathta/mizantropë.

<sup>21</sup> <http://promeneursdunet.fr/>

## Vlerësimi

Në të gjithë fushën e PVE ekziston nevoja për vlerësimin dhe metodologjinë e bazuar te provat. Kjo vlen edhe për PVE në punën me të rinjtë.

### StopR (BU)

Projekti StopR është prezantuar së fundi për të mbështetur punonjësit që punojnë me të rinjtë në trajtimin e radikalizimit. Ai i ndihmon ata të shtojnë dialogun mbi këtë temë. Synimi i projektit është të ndërtojë më tej mbi kapacitetin e punonjësve që punojnë me të rinjtë duke përdorur një platformë edukuese online. Kjo ofron një hapësirë ku organizatat që punojnë me parandalimin e radikalizimit të të rinjve mund të ndajnë përvojat dhe praktikat më të mira që kanë marrë vulën e cilësisë të zhvilluar brenda kornizës së projektit. Që prej korrikut 2017 ata kanë zhvilluar mes mjetesh të tjera edhe një listë me kritere cilësie për metodologjitë. Ata kanë ngritur gjithashtu grupe fokusi me punonjësit që punojnë me të rinjtë në të gjitha vendet e afiliuara. Projekti zhvillohet mes korrikut 2017 dhe tetorit 2018. Më shumë informacion: <http://www.szubjektiv.org/en/stopr/>.

## Shtojcë

1. British Council & SALTO Youth (2017) 'Young People and Extremism Resource Packs for Youth Workers' <https://www.salto-youth.net/rc/cultural-diversity/publications/youngpeopleandextremismpack/>
2. British Council & SALTO Youth (2017) 'Young People and Extremism Resource Packs for Youth Workers -Additional Material' <https://www.salto-youth.net/downloads/4-17-3567/SALTO%20Cultural%20Diversity%20Youth%20and%20Extremism-Additional%20Materials.pdf>
3. Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin dhe Kulturën (2017) 'The contribution of youth work to preventing marginalisation and violent radicalisation' <https://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/7f9cdb66-19c4-11e7-808e-01aa75ed71a1/language-en>
4. Prinzjakowitsch, W (2017). 'The preventative role of open youth work in radicalisation of open youth work' [http://www.newman.ac.uk/files/w3/research-centres/pdf/International\\_journal\\_of\\_open\\_youth\\_work.pdf?q=631](http://www.newman.ac.uk/files/w3/research-centres/pdf/International_journal_of_open_youth_work.pdf?q=631)
5. Radicalisation Awareness Network Issue paper (2016) 'Counter Narratives and Alternative Narratives' [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers/docs/issue\\_paper\\_cn\\_oct2015\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_cn_oct2015_en.pdf)
6. Radicalisation Awareness Network Issue paper (2016) 'The Root Causes of Violent Extremism' [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-papers/docs/issue\\_paper\\_root-causes\\_jan2016\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-papers/docs/issue_paper_root-causes_jan2016_en.pdf)
7. Uebisajti i Radicalisation Awareness Network (online) [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network_en)
8. Raporti i RAN YF&C (2018) 'Discussing taboos and controversial topics'. Do të jetë e disponueshme në uebsajtin e RAN në vitin 2018 [https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/ran-calendar\\_en](https://ec.europa.eu/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-calendar_en)

**Translated within:**

